





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

Prishtinë, 17.10.2018

Në bazë të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-089 mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr 82,21 tetor 2010), si dhe në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 17 të Rregullores nr. 02/2011 mbi Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 25 të Ligjit mbi vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjit NR.06/L-020 mbi Buxhetin e Kosovës për vitin 2018, lidhet ky:

**MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
INFRASTRUKTURORË NË KOMUNEN E GJAKOVËS**

Neni 1
Palët Nënshkruese

1. **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**, e përfaqësuar nga Ministri i MI-së, (në tekstin e mëtejme MI),
2. **KOMUNA E GJAKOVËS**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna)

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i projekteve infrastrukturore të cekura më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MI-së dhe Komunës për realizimin e projektit:

1. **“Ndërtimi – Asfaltimi i rrugës në fshatin Doblibare”**, kodi i projektit nr.632-13-062-511 në vlerë prej **524,761.64€**, ndarjet buxhetore të MI-së për vitin 2018 janë **524,761.64€**.

Çdo tejkallim të shumës së planifikuar e financon Komuna e Gjakovës.

Neni 3

Obligimet e MI-së

1. MI-ja i siguron mjetet për projektet nga paragrafi 2 i këtij Memorandumi dhe nga një kopje i dërgon Komunës.
2. Pagesat për financim të projekteve nga MI-ja do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës. Pagesat bëhen nga MI-ja deri në vlerën e financimit.
3. MI-ja cakton një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projektit nga fillimi deri në përfundim të kontratës. MI-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjegjësit dhe autorizimet e zyrtarit për mbikëqyrje.

Neni 4

Obligimet e Komunës

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MI.
2. Komuna obligohet të krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve për operatorët ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pagesë të filloj në implementimin e projekteve me kohë si dhe të siguroj specifikacionet teknike.
3. Komuna emëron projekt menaxherin / organin mbikëqyrës për realizimin e projektit, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve / pranimin teknik, në të cilën komisioni duhet të jetë një anëtar nga MI-ja.
4. Projekt menaxheri / organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve / furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve / furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
5. Komuna obligohet që të njofton MI-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projekteve dhe për këtë të kërkojë pëlqimin nga MI-ja.
 - 5.1. Komuna obligohet që në vend punishte të vendos tabelën Informuese (pano) me shënime për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

6. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët / furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MI-ja të kompletoj këto dokumente:
 - 6.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara);
 - 6.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vërtetuar në bazë të origjinalit nga menaxheri I prokurimit të Komunës;
 - 6.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit / organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimin nga ana e Komunës;
 - 6.4. Raportin e projekt menaxherit / organit mbikëqyrës / komisionit të pranimin mbi punët / furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);
 - 6.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MI-ja dhe
 - 6.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është I regjistruar në SMIFK – Departamenti I Thesarit – Ministria e Financave).
7. Komuna duhet të ndërmarr të gjitha masat që projektet të përfundoj në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve për projektin e tillë. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
8. Komuna është e obliguar të njoftoj MI-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.
9. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve përfshirë procedurat dhe kompensimin në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Ministrinë e Financave.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MI-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 7
Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes veti që ky Memorandum të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 8
Numri I Kopjeve

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje për secilën pale nënshkruese.

Neni 9
Pronësia e Projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, ky investim (projekt) do të kalojë në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 10
Hyrja ne fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Memorandum i Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit. Ky Memorandum i Mirëkuptimit e zëvendëson memorandumin e nënshkruar në mes të palëve me dt.12.10.2018.

